

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE JANAR 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	08.01.2025	Kërkesë ankesë në posten elektronike (e-mail) të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Kurbin, për njohje atësie dhe pasqyrimin në certifikaten familiare të dy fëmijëve të mitur.	09.01.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë ka kthyer përgjigje me poste elektronike (e-mail) banorit ankues të bashkisë Kurbin, ku theksohet se: 1- Korrigjimi i aktit të martesës bëhet sipas dispozitave të parashikuara në ligj nr. 10 129, datë 11.5.2009”Për gjendjen civile të ndryshuar, nga zyra e gjendjes civile përkatëse. 2- Ndërsa njohja e atësisë së fëmijes bëhet sipas dispozitave të parashikuara në nenin 181 e vijues të ligjit nr.9062, datë 8.5.2003”Kodi i Familjes” i Republikës së Shqipërisë . Organi i ngarkuar me përgjegjesi për trajtimin dhe dhënien zgjidhje brenda hapësirave ligjore të shqetësimit tuaj është zyra e Gjendjes civile bashkia Kurbin. Për këtë arsye duhet të paraqiteni personalisht pranë kësaj zyre për të marrë orientimin e duhur ligjor dhe për të plotësuar dokumentacionin që kjo zyrë u ka kërkuar në bazë të ligjit. Zyrat e Gjendjes civile në bashki nuk janë në varësi të Institucionit të Prefektit të Qarkut për këtë arsye shqetësimin tuaj duhet ta trajtoni pranë zyrës së Gjendjes Civile Kurbin dhe Kuçove pasi këto zyra janë përgjegjëse me ligj për të trajtuar ankesën tuaj .	E Plotë	Pa tarife
2	17.01.2025	Kërkesë në posten elektronike (e-mail) të	22.01.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë se: Bazuar në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin	E Deleguar	Pa tarife

¹Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar /E refuzuar / E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i bashkisë Lezhë, ku kërkohet informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit që kanë ndikuar në vlersimin e ndikimit në mjedis dhe në vendimarrjet për lejet dhe të shtyrjes së lejes së ndërtimit të projektit Kaskada Kacinar.		e Qarkut”, i ndryshuar, kërkesën e ka deleguar po me poste elektronike (e-mail) Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Zyrës Administrimit të Burimeve Ujore Ishëm-Erzen-Mat si organi përgjegjës, bazuar në Ligjin Nr.29/2024 “Për Burimet Ujore”, VKM Nr.221, datë 26.04.2018 “ Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, Kapitulli III, pika 5, kërkohet: 1. Trajtimin e kësaj kërkesë. 2. Të kthehet përgjigje ankimesit dhe ti vihen në dispozicion dokumentat e kërkuara. Në çdo komunikim me ankimesin të vihet në dijeni dhe Prefekti i Qarkut Lezhë.		
--	--	--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHKURT 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
3	19.02.2025	Ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njësisë Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë me pretendimin se Autoriteti Rrugor Shqiptar me ndërtimin e hyrje-daljes së Kallmetit në rrugën Lezhë – Shkodër ka zaptuar një pjesë të pronës së tijë pa lajmërim dhe dëgjese publike.	21.02.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar i është drejtuar me shkresë Autoritetit Rrugor Shqiptar si autoriteti përgjegjës për trajtimin e ankesës dhe vënien në dijeni Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë.	E Deleguar	Pa tarife
4	24.02.2025	Ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njësisë Administrative Rubik, Bashkia Mirditë me kërkesë për rivendosjen e aksesit me rrugë lidhëse në autostradën Rruga e Kombit.	27.02.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë : bazuar në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeversisjen Vendore” i është drejtuar me shkresë Bashkisë Mirditë trajtimin e ankesës brenda fushave dhe përgjegjësiive ligjore dhe vënien në dijeni Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë.	E Deleguar	Pa tarife

5	26.02.2025	Kërkesë për informacion në adresën e-mail të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Bashkisë Mirditë për adresën zyrtare të Drejtorisë së Administrimit të Mbrojtjes së Tokës Lezhë.	27.02.2025	Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë nëpërmjet adresës e-mail i ka dhënë adresën zyrtare të DAMT-së Lezhë banorit kërkuar.	E Plotë	Pa tarife
---	------------	--	------------	--	---------	-----------

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MARS 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
6	03.03.2025	Ankesë e banorëve të fshatit Kaçinar, bashkia Mirditë, mbi pezullimin e pikës 9 të rendit të ditës, të mbledhjes së datës 24.02.2025 të Këshillit Bashkiak Mirditë.	06.03.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar ka informuar kërkuar mbi aspektin ligjor dhe objektin (aktet normative) ku institucioni i prefektit ka autoritetin kontrollues.	E plotë	Pa tarifë
7	05.03.2025,	Kërkesë për informacion lidhur me shqetësimin e banorëve të lagjes “Skënderbej” të qytetit Lezhë, për fabrikën e përpunimit të mbetjeve shtazore.	10.03.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar ka informuar kërkuar mbi praktikën e ndjekur nga institucioni prej vitit 2020 në lidhje me problematikën.	E Plotë	Pa tarifë
8	11.03.2025	Kërkesë për informacion mbi zbatimin e ligjit Nr.33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripordorimin e informacionit të sektorit publik”.	25.03.2025	Është informuar Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi praktikën e ndjekur.	E Plotë	Pa tarifë
9	12.03.2025	Ankesë e shtetases mbi heqjen e përfitimit të grantit të qirasë nga programi i rindërtimit.	13.03.2025	Është informuar shtetësja mbi procedurën që është ndjekur.	E Plotë	Pa tarifë

10	13.03.2025	Kërkesë e shtetasit për kryerjen e punimeve pa leje në shtratin e një lumi në fshatin Jezull, bashkia Mirditë.	21.03.2025	Është adresuar ankesa në IKMT dega Lezhë për zgjidhje sipas ligjit	E deleguar	Pa tarifë
11	26.03.2025	Ankesë e shtetasve të fshatit Kaçinar, të bashkisë Mirditë, mbi procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektin Kaskada në Kaçinar.	Në shqyrtim	Në shqyrtim	Në shqyrtim	Pa tarifë

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PRILL 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
12	18.04.2025	Ankesë e znj. Bardha Gjergji, e cila ankohet mbi mungesën e vazhdueshme të energjisë elektrike në banesën e saj.	22.04.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar ka dërguar për trajtim ankesën e zonjës Bardha Gjergji tek OSHEE Lezhë, për kompetencë.	E deleguar	Pa tarifë

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
13	07.07.2025	Kërkesë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për tu pajisur me dokumentacion në lidhje me një rast të titujve të pronësisë.	15.07.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar ka dërguar dokumentacionin e kërkuar në lidhje me rastin.	E plotë	Pa tarifë

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE GUSHT 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
14	04.08.2025	Ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njësisë Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë me pretendimin se ASHK Lezhë që nga vitit 2018 nuk i ka legalizuar truallin në të cilin ka patur të ndërtuar një shtëpi e cila është konsideruar e pa banueshme pas termetit të viti 2019 dhe është shembur nga bashkia Lezhë.	08.08.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar i është drejtuar me shkresë ASHK Lezhë dhe Bashkisë Lezhë si institucione përgjegjëse për trajtimin e ankesës dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë.	E Deleguar	Pa tarife

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHTATOR 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
15	25.08.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njësisë Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin, për ndërhyrje mbi bllokimin e rrugës publike dhe verifikimin të titullit të pronësisë së subjektit privat. Banori i është dejtuar dhe	09.09.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar i është drejtuar me shkresë Bashkisë Kurbin, Zyres Vendore të Kadastres Kurbin, si institucione përgjegjëse për trajtimin e ankesës dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë. Është vënë në dijeni me shkresë dhe banori ankues.	E Deleguar	Pa tarife

		insitucioneve të tjera në të kaluaren por nuk ka marre zgjidhje ankesa e tij.				
--	--	---	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TETOR 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³		Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶
16	23.09.2025	Kërkesë - ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njesisë Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, për rrezikshmërinë e dëmtimit të linjës elektrike që kalon në varrezat, shkollën dhe kishën e Fshatit Gëziq.		29.09.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Drejtorisë Rajonale OSHE, Burrel si Institucion përgjegjëse për trajtimin e ankesës dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë sipas afateve të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Është vënë në dijeni me shkresë dhe banori ankues.	E Deleguar
17	30.09.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Lagjes Gurra, Njesisë Administrative Lezhë, Bashkia Lezhë, për shqetësime në lidhje me sigurinë elektrike dhe gjendjen e kabinave elektrike dhe kablllove të tensionit të larte.		08.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Drejtorisë Rajonale OSHE, Shkodër si Institucion përgjegjës për trajtimin e ankesës dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë sipas afateve të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Është vënë në dijeni me shkresë dhe banori ankues.	E Deleguar
18	07.10.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banor i Njesisë Administrative Rubik, Bashkia		10.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Bashkisë Mirditë që brenda fushës së përgjegjësisë, për trajtimin e ankesës dhe sqarimin e akuesit, si dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të	E Deleguar

		Mirditë, për mungesën e zgjidhjes problematikes së mungesës së kalimit me rrugë në prone private nga Bashkia Mirditë.			Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë.	
19	07.10.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga Institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për verifikim ankese nga banor i Njesisë Administrative Laç, Bashkia Kurbin, për disa ankesa drejtuar Bashkisë Kurbin për mospërfitim nga ana e ankuesit nga proçesi i rindërtimit të pasojave të termetit të vitit 2019.		21.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë me datë 10.10.2025 Bashkisë Kurbin si autotiteti përgjegjës dhe është vënë në dijeni me shkresë Ministria e Punëve të Brendshme dhe banori ankues. Me datë 17.10.2025 është protokolluar pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë përgjigjia e Bashkisë Kurbin ku sqarohemi se banori ankues nuk mund të përfitojë nga programi I rindërtimit pasi nuk ka dokument pronësie për banesën të cilën pretendon se është e tija. Çështja ndodhe në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe Bashkia Kurbin nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim pa u shprehur gjykata. Është vënë në dijeni me shkresë Ministria e Punëve të Brendshme dhe banori ankues.	E Përfunduar
20	08.10.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga Institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për verifikim ankese nga banor i Njesisë Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, për verifikim ndërtim pa leje i konstatuar nga ankuesi në Njesisë Administrative Fan, Bashkia Mirditë.		10.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Bashkisë Kurbin si autotiteti përgjegjës për planifikimin e territorit në nivel bashkie, referuar ligjit nr.107/2014 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar, në tratjtimin e ankesës si dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë.	20

21	13.10.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga Institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për verifikim ankese nga banor i Njësisë Administrative Milot, Bashkia Kurbin, për mos trajtimin financiar në kontributin e dhënë për fikjen e zjarreve në pyjet e Shkopetit si dhe bllokimin e mjetit tip Benz për mungesë dokumentacioni.		16.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Bashkisë Kurbin dhe Komisarariatit të Policisë Krujë si autotitete përgjegjëse në trajtimin e ankesës së banorit si dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë.	21
22	14.10.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga avokat i përfaqësuar me prokurë të posaçme, për paisje me të dhëna zyrtare nga rregjistrat e Zyrës së Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, për shtetas në Njësinë Administrative Balldre, Bashkia Lezhë.		14.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Zyrës së Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Lezhë si autoriteti përgjegjës për trajtimin e kërkesës dhe kthimin e përgjigjes studios ligjore.	E Deleguar

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE NËNTOR 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
23	21.10.2025	Kërkesë - ankesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga banore e Fshatit Patok, Njësia	23.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë Bashkisë Kurbin, IKMT Lezhë, referuar ligjit nr.107/2016 ‘Për Prefektin e Qarkut’, i ndryshuar, dhe		

		Administrative Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin, se ka bër ankes pranë I.V.M.T Kurbin dhe nuk ka gjetur zgjidhje për rikonstruksionin e banesës së saj për shkak të pamundësisë së ndërhyrjes në të.		ligjit nr.9780/2007, ‘‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme, i ndryshuar, si autoritete përgjegjëse për trajtimin e ankesës dhe vënien në dijeni institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë për zgjidhjen e dhënë. Eshtë vënë në dijeni me shkresë Ministria e Punëve të brendshme dhe banorja ankuese.
24	22.10.2025	Kërkesë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nga Institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme për verifikim anekese nga banor i Njësisë Administrative Martanesh, Bashkia Bulqizë, për ankesë të disa banorëve lidhur me një ndërtim pa leje të një tuneli nga një Shoqërie private ku pretendojnë se po devijohet rrjedha e perroit Lucane, degë e lumit Mat dhe tjetersuar rrjedhën natyrore të ujrave nga Baseni Mat drejt Basenit Drin, duke krijuar probleme për jetesen e këtyre banorëve.	27.10.2025	Prefekti i Qarkut Lezhë i është drejtuar me shkresë me datë 27.10.2025 Zyrës së Administrimit të Burimeve Lumore Ishëm-Erzen-Mat duke qenë se pretendimet e banoreve përkujnë Brenda kufijve territorial hidrografik të Basenit Mat, Bazuar në VKM Nr. 335, datë 19.6.2025, kërkohet verifikimi i këtij problemi dhe precedimi sipas ligjit, Të informohet zyrtarisht për mënyrën e trajtimit të këti problem institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë. Me datë 03.11.2025 është protokolluar pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë përgjigjia e Zyrës së Administrimit të Burimeve Lumore Ishëm-Erzen-Mat ku thekson se shoqeria private ka leje të përdorimit uJOR nga Këshilli i Basenit UJOR Drinë Bunë. Janë njohur me problematiken në të shkuaren dhe kanë bër verifikimin në terren dhe janë konstatuar problematikat dhe se Agjensia e Menaxhmit të Burimeve ujore ka ven në dijeni institucionet kompetente për zbatimin e ligjit. Shkresa po përpunohet nga Sektori i Zhvillimit Urban të Prefektit të Qarkut Lezhë.

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE DHJETOR 2025

Nr. Rendor ⁸	Data e kërkesës ⁹	Objekti i kërkesës ¹⁰	Data e përgjigjes ¹¹	Përgjigje ¹²	Mënyra e përfundimit të kërkesës ¹³	Tarifa ¹⁴
-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-
-	-	-	-	-	-	-

Regjistri përmban të përditësuar kërkesat dhe ankesat për periudhën deri me datë 23 Dhjetor 2025, ku janë paraqitur në total 24 kërkesa të protokolluara në adresën e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë.

⁸Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

⁹Data e regjistrimit të kërkesës

¹⁰Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

¹¹Data e kthimit të përgjigjes

¹²Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

¹³Përgjigja jepet E plotë / E kufizuar / E refuzuar / E deleguar

¹⁴Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.